

VENDIM
Nr. 226, datë 1.4.2026

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN
DHE SHQYRTIMIN E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE QË LIDHEN ME OSE
NDIKOJNË NË INFRASTRUKTURËN PUBLIKE KRITIKE, TEKNOLOGJINË
KRITIKE DHE MALLRAT ME PËRDORIM TË DYFISHTË, FURNIZIMIN ME TË
DHËNA KRITIKE, QASJEN NË INFORMACIONE TË NDJESHME APO PËR LIRINË
E MEDIAS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 7764, datë 2.11.1993, “Për investimet e huaja”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për procedurat për vlerësimin dhe shqyrtimin e investimeve të huaja direkte që lidhen me ose ndikojnë në infrastrukturën publike kritike, teknologjinë kritike dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, furnizimin me të dhëna kritike, qasjen në informacione të ndjeshme apo për lirinë e medias”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ky vendim shfuqizohet. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE

**PËR PROCEDURAT PËR VLERËSIMIN DHE SHQYRTIMIN E INVESTIMEVE TË
HUAJA DIREKTE QË LIDHEN ME OSE NDIKOJNË NË INFRASTRUKTURËN PUBLIKE
KRITIKE, TEKNOLOGJINË KRITIKE DHE MALLRAT ME PËRDORIM TË DYFISHTË,
FURNIZIMIN ME TË DHËNA KRITIKE, QASJEN NË INFORMACIONE TË NDJESHME
APO PËR LIRINË E MEDIAS¹**

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për vlerësimin dhe shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në Republikën e Shqipërisë që lidhen ose ndikojnë në infrastrukturën publike kritike, teknologjinë kritike dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, furnizimin me të dhëna kritike,

¹ Ky akt është përafëruar plotësisht me kërkesat e rregullore (BE) 2019/452, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Për krijimin e një kuadri për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte në Bashkimin Evropian”.

qasjen në informacione të ndjeshme ose për lirinë e medias, si dhe rregullat e koordinimit me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat dhe procedurat, me qëllim krijimin e kuadrit rregullator për investimet e huaja direkte në Republikën e Shqipërisë që lidhen ose ndikojnë në infrastrukturën publike kritike, teknologjinë kritike dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, furnizimin me të dhëna kritike, qasjen në informacione të ndjeshme ose për lirinë e medias, si dhe krijimin e përcaktimit të fushëveprimit dhe mënyrës së funksionimit të mekanizmit shtetëror për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte për arsye sigurie ose rendi publik.

Neni 3 Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

a) **“Investitor i huaj”**, një person fizik i një vendi të tretë ose një sipërmarrje e një vendi të tretë, që synon të bëjë ose ka bërë një investim të huaj të drejtpërdrejtë;

b) **“Investim i huaj direkt”**, një investim i çdo lloji nga një investitor i huaj që synon të krijojë ose të mbajë lidhje të qëndrueshme dhe të drejtpërdrejta midis investitorit të huaj dhe sipërmarrësit të cilit ose ndërmarrjes së cilës i vihet në dispozicion kapitali për të ushtruar një aktivitet ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë investimet që mundësojnë pjesëmarrje efektive në menaxhimin ose kontrollin e një shoqërie që kryen një aktivitet ekonomik;

c) **“Investim i huaj direkt që i nënshtrohet shqyrtimit”**, një investim i huaj direkt që i nënshtrohet vlerësimit ose hetimit formal, në përputhje me mekanizmin e shqyrtimit të përcaktuar në këtë vendim dhe që plotëson kriteret e mëposhtme në mënyrë kumulative:

i. ndërmarrja objekt ushtron veprimtari në një nga sektorët e listuar në shtojcën 1 dhe/ose shtojcën 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

ii. e drejta e Bashkimit Evropian ose e drejta ndërkombëtare e zbatueshme nuk e përjashton detyrimin për marrjen e autorizimit nga autoriteti kombëtar;

iii. si pasojë e investimit:

iii/1. arrihet ose tejkalohet një prag pjesëmarrjeje në të drejtat e votës kësaj rregulloreje;

iii/2. arrihet një interes kontrollues, pavarësisht përqindjes të së drejtave të votës;

iii/3. përvetësohet një interes kontrollues mbi asetet thelbësore të ndërmarrjes objekt;

iii/4. investimi cenon ose ekziston rrezik i arsyetuar se mund të cenojë sigurinë kombëtare, ose rendin publik të Republikës së Shqipërisë;

iii/5. plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 14, të kësaj rregulloreje;

ç) **“Investime të huaja direkte në sektorë të ndjeshëm”**, investimet që lidhen me infrastrukturën, asetet, mallrat ose shërbimet që janë thelbësore në sektorët e energjisë, transportit, shëndetësisë, teknologjive të informacionit dhe komunikimit ose infrastrukturës digjitale, sipas përcaktimeve të shtojcës 1 të kësaj rregulloreje dhe përqindja e pjesëmarrjes në ndërmarrjen e synuar arrin të paktën 25% (njëzet e pesë për qind), ose kur investitori i huaj rrit pjesëmarrjen në ndërmarrjen objekt në nivelet 30% (tridhjetë për qind), 40% (dyzet për qind), 50% (pesëdhjetë për qind) dhe 75% (shtatëdhjetë e pesë për qind);

d) **“Investimet e huaja direkte në sektorë veçanërisht të ndjeshëm”**, investimet kur përqindja e pjesëmarrjes në ndërmarrjen e synuar është të paktën 10% (dhjetë për qind) dhe aktiviteti i ndërmarrjes lidhet me infrastrukturën, asetet, teknologjitë, mallrat ose shërbimet, duke përfshirë shërbimet e kërkimit dhe zhvillimit, sipas përcaktimeve të shtojcës 2 të kësaj rregulloreje;

dh) **“Prag kontrolli në rast rritjeje pjesëmarrjeje”**, niveli i pjesëmarrjes së investitorit të huaj në kapitalin ose në të drejtat e votës së një ndërmarrjeje objekt, i cili, si pasojë e rritjes së mëtejshme të pjesëmarrjes pas investimit fillestar, arrin ose tejkalon pragjet 20%, 25%, 30%, 40%, 50%, 60%, 70% ose 75% dhe aktivizon procedurën e shqyrtimit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje;

e) **“Shqyrtim”**, një procedurë që lejon vlerësimin, hetimin, autorizimin, kushtëzimin, ndalimin ose tërheqjen e investimeve të huaja direkte, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje;

ë) **“Komiteti Ndërmarrës për Shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte”** (KNIHD), organi kolegjal vendimmarrës që kryen shqyrtimin e investimeve të huaja direkte për arsye sigurie ose rendi publik, sipas përcaktimeve të nenit 5, të kësaj rregulloreje;

f) **“Mekanizëm shqyrtimi”**, tërësia e instrumenteve, rregullave, procedurave dhe kompetencave të parashikuara në këtë rregullore për vlerësimin dhe shqyrtimin e investimeve të huaja direkte;

g) **“Ndërmarrje e një vendi të tretë”**, një ndërmarrje e themeluar ose e organizuar ndryshe sipas ligjeve të një vendi të tretë;

gj) **“Vendim shqyrtimi”**, vendimmarrja e KNIHD-së në përfundim të mekanizmit të shqyrtimit;

h) **“Sekretariati”**, struktura tekniko-administrative e përhershme që mbështet KNIHD-në dhe që ushtron funksione ndihmëse, administrative dhe koordinuese në kuadër të procedurës së shqyrtimit, pa kompetenca vendimmarrëse dhe që shërben si “Pika e vetme e kontaktit”;

i) **“Pikë kontakti”**, personi i caktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë, përgjegjës për koordinimin, shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin kombëtar, dhe ndërkombëtar, në kuadër të mekanizmit të shqyrtimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi;

j) **“Ministria përgjegjëse”**, ministria përgjegjëse për ekonominë;

k) **“Mallra me përdorim të dyfishtë”**, mallrat, përfshirë teknologjitë dhe *software*-t, që mund të përdoren si për qëllime civile, ashtu edhe për qëllime ushtarake, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian, të zbatueshme për Republikën e Shqipërisë;

l) **“Mallra ushtarake”**, mallrat që janë projektuar, zhvilluar, prodhuar, montuar ose modifikuar për përdorim ushtarak, përfshirë teknologjitë dhe *software*-t përkatëse, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian, të zbatueshme për Republikën e Shqipërisë;

ll) **“Mallra të kontrolluara”**, mallrat që, edhe pse nuk janë të listuara në listat e mësipërme, i nënshtrohen kontrollit shtetëror kur plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 11, të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar, në përputhje me instrumentet ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian, të zbatueshme për Republikën e Shqipërisë;

m) **“Ndërmarrje objekt”** konsiderohet çdo subjekt i regjistruar ose që ka detyrimin të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, në strukturën e të cilit është i pranishëm, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një investitor i huaj, përfshirë përmes pronësisë, kontrollit ose ndikimit të rëndësishëm;

n) **“Përvetësim i një interesi kontrollues”**, fitimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i aftësisë për të ushtruar ndikim vendimtar mbi veprimtarinë strategjike dhe vendimmarrëse të ndërmarrjes objekt, përmes të drejtave, kontratave ose çdo mjeti tjetër juridik apo faktik, individualisht, ose në bashkëpunim me persona të tjerë;

nj) **“Vend i tretë”**, çdo shtet, përveç Republikës së Shqipërisë, shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, me kusht që këto shtete të mos jenë drejtpërdrejt ose tërthorazi nën kontrollin ose ndikimin vendimtar të një vendi që përbën rrezik për sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë;

o) **“Investimet kritike”**, infrastrukturat, mallrat, teknologjitë dhe burimet, të cilat kanë rëndësi thelbësore për ruajtjen e funksioneve shoqërore jetike, pasi ndërprerja, shkatërrimi, dështimi ose humbja e tyre do të sillte pasoja serioze për shëndetin, sigurinë, ose mirëqenien ekonomike dhe shoqërore të popullsisë, si dhe për funksionimin efektiv të institucioneve shtetërore dhe ekonomisë në Republikën e Shqipërisë;

p) **“Media”**, çdo subjekt ose platformë që, në mënyrë profesionale ose të organizuar, prodhon, redakton ose shpërndan për publikun përmbajtje informative, audio, audiovizive ose editoriale, përmes mediave audiovizive, botimeve të shkruara ose platformave digjitale përfshirë OTT/IPTV, dhe që ushtron ndikim në informimin e publikut, formimin e opinionit publik ose garantimin e pluralizmit të informacionit, sipas legjislacionit në fuqi;

q) **“Furnizim me të dhëna kritike”**, çdo formë sigurimi, gjenerimi, përpunimi, administrimi, ruajtjeje, transferimi ose vënieje në dispozicion të të dhënave, sistemeve të informacionit ose infrastrukturës digjitale, që janë thelbësore për funksionimin e shërbimeve jetike, infrastrukturave kritike ose institucioneve publike dhe ndërprerja, cenimi ose humbja e të cilave mund të ketë pasoja serioze për sigurinë kombëtare, rendin publik ose mirëqenien ekonomike dhe shoqërore;

r) **“Infrastrukturë kritike e informacionit”**, tërësia e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit që ofrojnë shërbime, cenimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishte impakt serioz në shëndetin, sigurinë, mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe funksionimin efektiv të ekonomisë në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të legjislacionit për sigurinë kibernetike;

rr) **“Informacion i ndjeshëm”**, për qëllimet e këtij vendimi, përfshin çdo informacion, të dhënë ose material, përfshirë informacionin e klasifikuar sipas ligjit për informacionin e klasifikuar, të dhëna personale sensitive, informacion strategjik, ekonomik, teknik ose institucional, qasja, përpunimi ose kontrolli i paautorizuar i të cilit mund të cenojë sigurinë kombëtare, rendin publik ose interesat themelore të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4 Fushëveprimi

1. Fusha e zbatimit të kësaj rregulloreje përfshin investimet e huaja direkte të realizuara në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimit të nenit 3, shkronja “c”, dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 14 të kësaj rregulloreje.

2. Nga zbatimi i kësaj rregulloreje përjashtohen sa vijon:

a) Blerja e aksioneve nga persona fizikë që synojnë vetëm investime financiare pa qëllimin ose mundësinë e ndikimit në administrimin, ose kontrollin e ndërmarrjes (investime portofoli);

b) Riorganizime të brendshme të grupeve të kompanive ose bashkime pa ndryshim të kontrollit nga investitorët e huaj;

c) Procedurat konkurruese në vazhdim me një ofertë të detyrueshme të paraqitur dhe kontratat e shfrytëzimit që nuk janë finalizuar deri në hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

3. Për të përcaktuar nëse një investim i huaj direkt mund të çojë në një kërcënim ndaj sigurisë ose rendit publik, shqyrtohen efektet e këtij investimi në sektorët e listuar në shtojcat 1 dhe 2, faktorët e riskut dhe kriteret e përzgjedhjes, të përcaktuara në nenin 14, të kësaj rregulloreje.

4. Gjatë vlerësimit të një kërcënimi të mundshëm, sipas pikës 3, për shqyrtimin e investimit të huaj merren në konsideratë, në veçanti:

a) nëse investitori i huaj kontrollohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga qeveria e një vendi të tretë, duke përfshirë organet shtetërore ose forcat e armatosura të një vendi të tretë, përmes strukturës së pronësisë ose financimit të konsiderueshëm;

b) nëse investitori i huaj ka qenë tashmë i përfshirë në aktivitete që ndikojnë në sigurinë ose rendin publik në një shtet anëtar të BE-së;

c) nëse ekziston një rrezik serioz që investitori i huaj të përfshihet në aktivitete të paligjshme ose kriminale.

KAPITULLI II

STRUKTURAT DHE PROCEDURAT E MEKANIZMIT TË SHQYRTIMIT

Neni 5

Komiteti Ndërmënyor për Shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte

1. Komiteti Ndërmënyor për Shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte (në vijim “KNIHD”) është organ kolegjal vendimmarrës, i cili shqyrton investimet e huaja direkte sipas parashikimeve të këtij vendimi, me qëllim mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe rendit publik.

2. KNIHD-ja kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, i cili drejton procesin e shqyrtimit dhe garanton funksionimin dhe vendimmarrjen e Komitetit (në vijim referuar si “Kryetari”).

3. KNIHD-ja përbëhet nga anëtarë me të drejtë vote, përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

a) ministria përgjegjëse për ekonominë;

b) ministria përgjegjëse për financat;

c) ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë;

ç) ministria përgjegjëse për mbrojtjen;

d) ministria përgjegjëse për punët e brendshme;

dh) ministria përgjegjëse për punët e jashtme;

e) ministria përgjegjëse për drejtësinë;

ë) Agjencia Kombëtare e Falimentimit (AKF);

f) Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF);

g) Agjencia Kombëtare e Shqërisë së Informacionit (AKSHI);

gj) Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE);

h) Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA);

i) përfaqësues të institucioneve publike, përfituese fundore të tyre, sipas objektit të investimeve të huaja direkte;

4. Vendimmarrja e KNIHD-së është kolegjiale dhe realizohet në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje.

5. Në varësi të objektit, sektorit ose natyrës së investimit të huaj direkt, çdo anëtar i KNIHD-së ka të drejtë të ftojë për të marrë pjesë në mbledhje, pa të drejtë vote, drejtues ose përfaqësues të institucioneve të tjera publike apo autoriteteve përgjegjëse rregullatore, kur prania e tyre vlerësohet e nevojshme.

6. Investimet e huaja direkte i nënshtrohen shqyrtimit përpara përfundimit të tyre, në përputhje me procedurat dhe afatet e parashikuara në këtë vendim. Shtetet anëtare mund të japin komente dhe Komisioni mund të japë një opinion jo më vonë se 15 muaj pasi të jetë përfunduar investimi i huaj direkt.

7. Informacioni i marrë gjatë procedurave të shqyrtimit përbën informacion konfidencial dhe trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke u përdorur vetëm për qëllimin për të cilin është kërkuar dhe në përputhje me parashikimet ligjore për konfidencialitetin.

8. Deri më 31 mars të çdo viti, ministri përgjegjës për ekonominë i paraqet Këshillit të Ministrave dhe ky i fundit Komisionit Evropian raportin vjetor për vitin kalendarik paraardhës, i cili përfshin informacion të përmbledhur mbi investimet e huaja direkte që kanë ndodhur në territor, në bazë të informacionit të disponueshëm, si dhe informacion të përmbledhur mbi kërkesat e marra nga shtetet anëtare të BE-së dhe informacion të përmbledhur mbi zbatimin e mekanizmave të shqyrtimit.

Neni 6

Organizimi i brendshëm dhe drejtimi i KNIHD-së

1. Veprimtaria dhe mbledhjet e KNIHD-së drejtohen nga kryetari, i cili:

a) thërret mbledhjet e Komitetit, cakton rendin e ditës dhe siguron njoftimin e anëtarëve, në përputhje me afatet procedurale;

b) drejton diskutimet, garanton respektimin e rregullave procedurale dhe siguron zhvillimin e mbledhjeve në mënyrë të paanshme dhe efikase;

c) kërkon, përmes sekretariatit, dhe administron informacionin, dokumentacionin, dhe opinionet teknike të nevojshme për shqyrtimin dhe vendimmarrjen e Komitetit;

ç) siguron koordinimin ndërinstitucional, përfshirë kërkimin e vlerësimeve teknike, opinioneve ose informacionit shtesë nga institucionet kompetente, kur kjo është e nevojshme për shqyrtimin e investimit;

d) mbikëqyr veprimtarinë e sekretariatit dhe siguron përgatitjen e materialeve, procesverbaleve dhe dokumentacionit përkatës të mbledhjeve;

dh) ushtron çdo kompetencë tjetër të parashikuar me ligj ose në këtë vendim.

2. Në rast mungese ose pamundësie për ushtrimin e detyrës, kryetari zëvendësohet nga personi i deleguar me shkrim, i cili ushtron të gjitha kompetencat e kryetarit për periudhën përkatëse.

Neni 7

Kuorumi, votimi dhe vendimmarrja

1. KNIHD-ja merr vendime në mënyrë kolegjiale mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur, vlerësimeve teknike, opinioneve institucionale dhe diskutimeve të zhvilluara në mbledhje, në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin në fuqi.

2. Komiteti konsiderohet i mbledhur kur në mbledhje marrin pjesë shumica e anëtarëve me të drejtë vote, pas përjashtimit të çdo anëtar që ndodhet në konflikt interesi dhe përfshirjes, sipas rastit, të zëvendësuesit ligjor.

3. Vendimet e Komitetit merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë. Pjesëmarrja e kryetarit dhe e përfaqësuesve të institucioneve përgjegjëse për fushën përkatëse të investimit është e detyrueshme në mbledhje dhe vendimmarrje.

4. Kryetari i KNIHD-së, sekretariati, si dhe çdo anëtar i KNIHD-së ka të drejtë të kërkojë opinion teknik për investimet e huaja direkte që paraqesin rrezik të lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare, sipas fushës së sektorit të investimit të huaj.

5. Vlerësimi teknik, si më lart, fokusohet në analizën e rrezikut që investimi mund të paraqesë për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, veçanërisht por pa u kufizuar, në lidhje me:

a) mallrat, teknologjitë, shërbimet dhe asistencën teknike ushtarake;
b) mallrat, teknologjitë dhe shërbimet me përdorim të dyfishtë;
c) mallrat, teknologjitë ose shërbimet që, edhe pse nuk janë të përfshira në listat e kontrollit, i nënshtrohen kontrollit shtetëror sipas nenit 11, të ligjit nr. 46/2018 (parimi *catch-all*);

ç) rreziqet kibernetike, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) përfshirë cenimin e sigurisë së sistemeve të informacionit dhe komunikimit, infrastrukturave kritike digjitale, sistemeve industriale (OT/SCADA), integritetit, konfidencialitetit dhe disponueshmërisë së të dhënave kritike, informacionit të ndjeshëm, si dhe infrastrukturës përkatëse, rrezikun e aksesit të paautorizuar, ndërhyrjeve në distancë ose krijimit të varësive teknologjike nga një vend i tretë;

d) lirinë e medias, pluralizmin e informacionit dhe pavarësinë editoriale, në masën që investimi i huaj, për shkak të natyrës, strukturës së pronësisë ose shkallës së kontrollit që krijon, mund të cenojë këto parime përmes përqendrimit të pronësisë mediatike, ushtrimit të ndikimit të huaj të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, apo të ndikojë në rendin publik dhe sigurinë kombëtare.

6. Vlerësimi teknik merret në konsideratë në mënyrë të posaçme nga KNIHD-ja në procesin e vendimmarrjes, përfshirë vendosjen e kushteve ose masave lehtësuese, pa cenuar kompetencat vendimmarrëse të Komitetit.

7. Vendimet e Komitetit arsyetohen, pasqyrojnë vlerësimin e rrezikut për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare dhe përcaktojnë, sipas rastit:

a) miratimin e investimit;
b) miratimin me kushte ose masa zbutëse të investimit;
c) pezullimin e shqyrtimit deri në paraqitjen e informacionit shtesë;
ç) ndalimin ose anulimin e investimit, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.

8. Vendimet pasqyrohen në procesverbal, i cili përmban përbërjen e Komitetit, konstatimin e kuoromit, rezultatet e votimit, çdo përjashtim ose zëvendësim për shkak të konfliktit të interesave dhe arsyetimin përkatës.

9. Vendimet e KNIHD-së janë akte administrative individuale, të cilat i nënshtrohen ankimit dhe shqyrtimit gjyqësor, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe legjislacionin në fuqi.

10. Anëtarët e KNIHD-së nuk mund të abstenojnë.

1. Çdo anëtar i KNIHD-së ka detyrimin të deklarojë me shkrim, menjëherë dhe përpara shqyrtimit të çështjes, çdo rrethanë që përbën ose mund të përbëjë konflikt interesi, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave.

2. Në rast se konstatohet ekzistenca e konfliktit të interesave, kryetari urdhëron përjashtimin e menjëhershëm të anëtarit nga shqyrtimi, diskutimi dhe votimi për çështjen përkatëse.

3. Anëtar i përjashtuar nuk merr pjesë në diskutime, nuk ka akses në dokumentacionin përkatës dhe nuk qëndron i pranishëm gjatë diskutimit dhe votimit.

4. Anëtar i përjashtuar zëvendësohet për çështjen konkrete nga personi i autorizuar, sipas parashikimeve në ligj dhe aktin e emërimit.

5. Përjashtimi dhe zëvendësimi i anëtarit, si dhe arsyet përkatëse pasqyrohen detyrimisht në procesverbal.

Neni 9

Sekretariati i KNIHD-së

1. Pranë KNIHD-së funksionon sekretariati, si strukturë tekniko-administrative mbështetëse, e cila siguron funksionimin efektiv të procesit të shqyrtimit të investimeve të huaja direkte.

2. Sekretariati nuk ka kompetenca vendimmarrëse dhe ushtron funksionet e tij, në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

3. Sekretariati ushtron, në veçanti, këto funksione:

a) Pranon, regjistron dhe administron njoftimet dhe dokumentacionin për investimet e huaja direkte, objekt shqyrtimi, sipas kriterëve të kësaj rregulloreje;

b) Verifikon plotësinë formale të dokumentacionit dhe, kur është e nevojshme, kërkon plotësime;

c) Përgatit dosjen administrative dhe materialet për shqyrtim në KNIHD;

ç) Identifikon sektorin dhe pragjet përkatëse, sipas kësaj rregulloreje;

d) Koordinon kërkesat për opinione dhe vlerësime teknike nga institucionet kompetente dhe ndjek afatet përkatëse;

dh) Përgatit rendin e ditës së mbledhjeve, në bashkëpunim me kryetarin;

e) Siguron mbështetjen procedurale të mbledhjeve dhe mban procesverbalet;

ë) Administron njoftimin e vendimeve dhe arkivimin e dokumentacionit;

f) Funksionon si pika e vetme e kontaktit, në përputhje me nenin 10, të kësaj rregulloreje;

g) Monitoron, kryesisht dhe në mënyrë periodike, Regjistrin Tregtar dhe Regjistrin e Pronarëve Përfitues mbi çdo ndryshim të ndodhur në strukturën pronësore apo në të dhëna të tjera të ndërmarrjeve objekt.

Në rast konstatimi të ndryshimeve, për të cilat nuk është njoftuar autoriteti, zbatohet procedura e shqyrtimit *ex officio*, sipas parashikimeve të nenit 20, të kësaj rregulloreje.

4. Sekretariati siguron konfidencialitetin e informacionit, mbrojtjen e të dhënave dhe trajtimin e informacionit të klasifikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Pika kombëtare e kontaktit

1. Pika kombëtare e kontaktit caktohet nga ministri përgjegjës për ekonominë për qëllimet e bashkëpunimit, koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit me Komisionin Evropian dhe

autoritetet kompetente të shteteve të tjera, në përputhje me rregulloren (BE) 2019/452 për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte.

2. Pika kombëtare e Kontaktit ka këto funksione:

a) Transmeton dhe merr njoftime, kërkesa dhe informacione, në kuadër të mekanizmit të bashkëpunimit të parashikuar nga rregullorja (BE) 2019/452;

b) Koordinon mbledhjen, verifikimin dhe konsolidimin e informacionit nga institucionet kombëtare kompetente, si dhe nga autoritetet e tjera homologe ndërkombëtare në vende që nuk kualifikohen si “vende të treta”;

c) Siguron respektimin e afateve dhe procedurave përkatëse, në përputhje me rregulloren (BE) 2019/452 dhe këtë rregullore;

ç) Garanton konfidencialitetin, sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave të klasifikuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) Vepron si ndërmjetës komunikimi ndërmjet KNIHD-së, institucioneve kombëtare kompetente, Komisionit Evropian, autoriteteve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe autoriteteve të tjera homologe ndërkombëtare që nuk kualifikohen si “vende të treta”.

Ushtrimi i funksioneve të pikës kombëtare të kontaktit nuk cenon kompetencat vendimmarrëse të KNIHD-së dhe nuk përbën delegim të kompetencave vendimmarrëse.

3. Pika e kontaktit caktohet sipas urdhrat të ministrit përgjegjës për ekonominë, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Neni 11

Grupi i punës

1. Për shqyrtimin e investimeve që paraqesin kompleksitet të veçantë teknik, kryetari i KNIHD-së, me propozim të sekretariatit, mund të krijojë grupe pune *ad hoc*, ku përfshihen edhe përfaqësues të anëtarëve të përhershëm, për përgatitjen e analizave teknike dhe mbështetjen e procesit të shqyrtimit.

2. Grupet e punës nuk kanë kompetenca vendimmarrëse dhe veprojnë në përputhje me udhëzimet e kryetarit të KNIHD-së dhe drejtuesit të sekretariatit.

3. Deri më 31 mars të çdo viti, ministri përgjegjës për ekonominë i paraqet Këshillit të Ministrave dhe ky i fundit Komisionit Evropian raportin vjetor për vitin kalendarik paraardhës, i cili përfshin informacion të përmbledhur mbi investimet e huaja direkte që kanë ndodhur në territor, në bazë të informacionit të disponueshëm, si dhe informacion të përmbledhur mbi kërkesat e marra nga shtetet anëtare të BE-së dhe informacion të përmbledhur mbi zbatimin e mekanizmave të shqyrtimit.

KAPITULLI III

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Neni 12

Bashkëpunimi në shqyrtimin e investimeve të huaja direkte

1. Me qëllim mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe rendit publik, sekretariati kryen shqyrtimin paraprak të investimeve të huaja direkte brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe njofton institucionet përkatëse vendase dhe, kur është e aplikueshme, partnerët ndërkombëtarë përkatës.

2. Për qëllime të zbatimit të këtij akti, shkëmbimi i informacionit, dokumentacionit dhe të dhënave ndërmjet institucioneve publike kompetente vendase, si dhe me autoritetet homologe të huaja dhe institucionet e Bashkimit Evropian kryhet ekskluzivisht përmes sekretariatit.

3. Sekretariati vepron si pikë qendrore koordinimi dhe kontakti për mbledhjen, përpunimin, administrimin dhe transmetimin e informacionit të nevojshëm për shqyrtimin, vlerësimin dhe vendimmarrjen, lidhur me investimet e huaja direkte që mund të cenojnë sigurinë ose rendin publik.

4. Me kërkesë të sekretariatit, institucionet publike kompetente vendase janë të detyruara të vënë në dispozicion, brenda afateve të përcaktuara, çdo informacion, dokumentacion ose të dhënë që lidhet drejtpërdrejt me objektin e shqyrtimit, përfshirë të dhëna nga regjistra publikë, sisteme informative dhe burime zyrtare të besueshme.

5. Për qëllime të lehtësimit dhe standardizimit të shkëmbimit të informacionit, sekretariati mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi ose protokolle teknike me institucionet publike kompetente vendase dhe, kur është e nevojshme, me autoritetet homologe të huaja.

6. Lidhja e këtyre marrëveshjeve nuk përbën kusht për ushtrimin e detyrimit për shkëmbimin e informacionit sipas këtij akti. Sekretariati duhet të marrë në konsideratë siç duhet të gjitha komentet dhe opinionet e dhëna nga autoritetet kompetente kombëtare apo ndërkombëtare, sipas rastit, përpara se t'i bëjë Komitetit një propozim për vendimin përfundimtar të shqyrtimit.

7. Afatet kohore për paraqitjen e komenteve ose opinioneve nga autoritetet kompetente do të përcaktohen në udhëzimet e brendshme, në zbatim të kësaj rregulloreje dhe nuk duhet të tejkalojnë një periudhë të arsyeshme të nevojshme për shqyrtimin efektiv të investimit.

8. Në raste të jashtëzakonshme kur siguria kombëtare ose rendi publik kërkojnë veprim të menjëhershëm, sekretariati/KNIHD nëse çështja po hetohet pranë këtij organi mund të marrë një vendim para mbarimit të afateve standarde kohore, duke njoftuar menjëherë autoritetet e tjera përkatëse dhe duke justifikuar siç duhet nevojën për veprim urgjent.

9. Bashkëpunimi midis autoriteteve kompetente do të zhvillohet nëpërmjet pikave të kontaktit, të caktuara brenda 90 ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duke siguruar shkëmbim të koordinuar dhe të sigurt informacioni.

Neni 13

Bashkëpunimi me vendet anëtare për investimet e huaja direkte që nuk i nënshtrohen shqyrtimit

1. Kur një investim i huaj direkt, i planifikuar ose i përfunduar në një juridiksion tjetër, konsiderohet se ka të ngjarë të ndikojë në sigurinë kombëtare ose rendin publik të atij juridiksioni dhe/ose Shqipërisë, sekretariati siguron shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin përkatës, në rastet kur:

a) vihet në dijeni zyrtarisht, nëpërmjet mekanizmave kombëtarë ose ndërkombëtarë për ekzistencën e një investimi të tillë;

b) konstaton *ex officio*, mbi bazën e informacionit të disponueshëm, se investimi mund të ketë ndikim në sigurinë kombëtare ose rendin publik të një juridiksioni tjetër dhe/ose Shqipërisë.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1, pas miratimit nga kryetari i KNIHD-së, sekretariati i paraqet një kërkesë zyrtare për informacion, komente ose opinion autoritetit kompetent të juridiksionit tjetër ku investimi është planifikuar ose është përfunduar. Këto komente ose opinione i dërgohen njëkohësisht KNIHD-së për njohje.

3. Kur sekretariati vihet në dijeni se një investim i huaj direkt mund të ndikojë në sigurinë kombëtare ose rendin publik në juridiksione të shumëfishta, pas miratimit nga kryetari i KNIHD-së, mund të japë një vërejtje drejtuar shtetit ku është planifikuar ose përfunduar investimi. Vërejtjet mund të lëshohen pavarësisht nëse juridiksione të tjera kanë dhënë komente dhe duhet të jenë të justifikuara.

4. Sekretariati ka të drejtë të kërkojë informacionin përkatës nga juridiksioni ku është planifikuar ose përfunduar investimi, për të mundësuar dhënien e komenteve ose dhënien e një opinioni. Çdo kërkesë e tillë duhet të jetë e justifikuar, e kufizuar në informacionin e domosdoshëm, për këto qëllime dhe proporcionale, duke mos krijuar barrë të tepërt administrative për autoritetet që e ofrojnë.

5. Komentet ose vërejtjet duhet t'i drejtohen juridiksionit ku është planifikuar ose përfunduar investimi dhe duhet të dërgohen brenda një afati kohor të arsyeshëm, në çdo rast jo më vonë se 35 ditë kalendrike pas marrjes së informacionit të kërkuar. Në rastet kur opinioni vjen pas komenteve nga juridiksione të tjera, domethënë, çdo shtet i huaj, duke përfshirë shtetet anëtare të BE-së, vendet fqinje ose vende të tjera, me të cilat ka një shkëmbim formal informacioni, në lidhje me investimin, mund të lejohen 15 ditë kalendrike shtesë për lëshimin e opinionit. Të gjitha komentet ose opinionet duhet të jenë të justifikuara.

6. Autoriteti kompetent në juridiksionin ku është planifikuar ose përfunduar investimi i huaj direkt, përfshirë Shqipërinë për investimet vendase, duhet të marrë në konsideratë siç duhet të gjitha komentet dhe vërejtjet e marra. Bashkëpunimi sipas këtij neni do të zhvillohet nëpërmjet pikave të kontaktit të caktuara, duke siguruar shkëmbim informacioni të sigurt dhe të koordinuar.

Neni 14

Kriteret e vlerësimit të riskut dhe përzgjedhjes

1. Një investim i huaj direkt vlerësohet për arsye sigurie ose rendi publik kur plotësohet një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme:

- a) Investimi kryhet nga një investitor i huaj nga një vend i tretë;
- b) Ndërmarrja objekt ushtron veprimtari në një sektor të ndjeshëm ose veçanërisht të ndjeshëm, sipas përcaktimeve të shtojcës 1 ose shtojcës 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje;
- c) Pjesëmarrja e huaj në sektorët e ndjeshëm ose veçanërisht të ndjeshëm përlllogaritet sipas pikës 2, të këtij neni;
- ç) Investimi kryhet nga një investitor i Bashkimit Evropian që kontrollohet drejtpërdrejt ose tërthorazi:
 - i. nga një palë e tretë;
 - ii. nga një qeveri e një vendi të tretë, duke përfshirë entitetet shtetërore ose ushtarake;
- d) Nëse një investitor i BE-së përfshin një pjesëmarrje prej 10% ose më shumë nga një vend i tretë, ose qeveria e tij dhe objekti operon në sektorë veçanërisht të ndjeshëm. Kjo vlen edhe nëse investitori i BE-së merr fonde, kredi ose burime të tjera nga një vend i tretë që mund të ndikojnë në vendimet strategjike, edhe nëse pjesëmarrja në kapital është nën 10%;
- dh) Kontrolli ose ndikimi vendimtar i huaj ushtrohet përmes të drejtave të veçanta, marrëveshjeve, instrumenteve financiare, kushteve të financimit, kontratave të menaxhimit, të drejtave të vetos, aksesit në informacion kritik ose çdo forme tjetër që mundëson ndikim të qëndrueshëm mbi vendimmarrjen strategjike të ndërmarrjes objekt;
- e) Struktura e pronësisë, kontrollit ose financimit është komplekse, e fragmentuar, jotransparente ose e ndërmjetësuar përmes juridiksioneve me rrezik të lartë, struktura trusti,

entiteteve *off shore* ose mjeteve të tjera që pengojnë identifikimin e pronarit përfitues përfundimtar, sipas legjislacionit të parandalimit të pastrimit të parave dhe mbrojtjes nga terrorizmi;

ë) Investimi ka ose synohet të ketë për qëllim përdorime ushtarake, paramilitare ose të sigurisë, përfshirë integrimin e aseteve, teknologjive ose shërbimeve në sisteme armësh, pajisje mbrojtëse, sisteme komanduese, vëzhgimi, mbledhjeje informacioni ose kontrolli;

f) Investimi ka ose synohet të ketë për qëllim mbështetjen, lehtësimin ose kryerjen e veprimtarive terroriste, përfshirë financimin, mbështetjen logjistike, teknologjike ose operacionale të tyre;

g) Investimi ka ose synohet të ketë si pasojë cenimin, ndërprerjen ose komprometimin e funksionimit të infrastrukturës kritike, shërbimeve thelbësore ose sistemeve strategjike publike apo private;

gj) Investimi ka ose synohet të ketë si pasojë aksesin, përpunimin, transferimin ose kontrollin e paautorizuar mbi të dhëna personale, sensitive, kritike, shtetërore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

h) Mungojnë garanci të besueshme dhe të verifikueshme, lidhur me përdoruesin final, destinacionin përfundimtar, kontrollin e zinxhirit të furnizimit ose mekanizmat e mbikëqyrjes pas realizimit të investimit;

i) Rrethanat e investimit krijojnë ose mund të krijojnë varësi strategjike, ekspozim të tepruar ndaj ndikimit të huaj ose rrezik të humbjes së kontrollit efektiv mbi kapacitete, teknologji ose shërbime kyçe për sigurinë kombëtare;

j) Investimi çon ose mund të çojë në kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi media audiovizive, media të shkruara, platforma digjitale informative ose shërbime të shpërndarjes së përmbajtjes, në një mënyrë që cenon pluralizmin e medias ose pavarësinë editoriale, veçanërisht kur shoqërohet me mungesë transparence në pronësinë, financimin ose burimet ekonomike të subjektit mediatik, përfshirë rastet kur pronari përfitues përfundimtar nuk identifikohet qartësisht ose lidhet me qeveri, entitete shtetërore ose struktura politike të një vendi të tretë.

2. Pjesëmarrja e huaj në ndërmarrjet në sektorë të ndjeshëm ose veçanërisht të ndjeshëm llogaritet kur:

a) një person blerës mban të paktën kuotën përkatëse të të drejtave të votës së këtij personi tjetër të huaj ose ushtron një interes kontrollues mbi këtë person tjetër të huaj;

b) një person i tretë i huaj mban të paktën kuotën e specifikuar të të drejtave të votës të personi blerës dhe të personi tjetër i huaj;

c) një person blerës ka lidhur një marrëveshje me këtë person tjetër të huaj për ushtrimin e përbashkët të të drejtave të votës;

ç) një marrëveshje midis dy ose më shumë personave të huaj që marrin pjesë në sipërmarrjen e synuar për ushtrimin e përbashkët të të drejtave të votës, nëse ata së bashku mbajnë të paktën kuotën minimale të të drejtave të votës, ose përfundimin e një marrëveshjeje për ushtrimin e përbashkët të të drejtave të votës midis dy ose më shumë personave të tillë të huaj, nëse të paktën njëri prej tyre mban të paktën këtë kuotë të të drejtave të votës. Për efekt të këtij paragrafi, kuota minimale do të thotë 50% e të drejtave të votës ose çdo pjesëmarrje më e ulët në aksione që jep të drejtën e vetos, ose të ushtrimit të ndikimit vendimtar mbi vendimet strategjike të subjektit.

3. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, “kuota përkatëse” do të jenë pragjet e specifikuara në nenin 3, shkronjat “ç”, “d”, “dh”.

Neni 15

Kërkesa për autorizim (*standstill*)

1. Përpara përfundimit të një investimi që përmbush kriteret e nenit 14, të kësaj rregulloreje, investitori i huaj dhe/ose ndërmarrja objekt ka detyrimin të paraqesë kërkesë për autorizim pranë sekretariatit.

2. Faza parainvestimit përfshin:

a) periudhën pas lidhjes së kontratës paraprake për përvetësimin deri në regjistrimin e saj në regjistrat publikë;

b) përfundimin e veprimeve juridike të nevojshme për fitimin e kontrollit ose aseteve;

c) në rast të një oferte publike, momentin pas shpalljes së qëllimit për paraqitjen e ofertës.

3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës, sekretariati verifikon plotësinë formale të dokumentacionit dhe njofton për çdo mangësi ose pasaktësi.

4. Plotësimi i dokumentacionit nga investitori i huaj dhe/ose ndërmarrja objekt kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës për plotësim.

5. Kur ndërmarrja objekt merr dijeni për një transaksion që kërkon autorizim sipas këtij vendimi, por, për të cilin nuk është paraqitur kërkesë, ajo njofton sekretariatit menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga marrja e dijenisë. Mosnjoftimi përbën shkak për përgjegjësi solidare me investitorin e huaj dhe/ose personin përvetësues.

6. Mosparaqitja e dokumentacionit brenda afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni sjell anulimin e procedurës së autorizimit, pa cenuar të drejtën për riaplikim. Dorëzimi i dokumentacionit nuk nënkupton pranimin e kërkesës ose miratimin e investimit.

7. Brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga plotësimi i dokumentacionit, sekretariati ia dërgon dokumentacionin për vendimmarrje anëtarëve të KNIHD-së, si dhe njofton palët e tjera të interesuara sipas nenit 5, të këtij neni.

Neni 16

Përmbajtja e kërkesës për autorizim

1. Kërkesa për autorizim përmban, në veçanti,:

a) emrin dhe adresën e secilit person përvetësues, si dhe, kur janë të disponueshme, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike;

b) emrin dhe adresën e ndërmarrjes objekt, si dhe përshkrimin e saktë të veprimtarive ekonomike të personave dhe ndërmarrjeve të përfshira, përfshirë përshkrimin e tregut përkatës;

c) të dhënat e personit të autorizuar për ndjekjen e procedurës (prokurë noteriale) nëse ka;

ç) përshkrimin e arsyeve të ndryshimit të ortakut/aksionarit kontrollues;

d) vlerësimin e efektit të pritshëm dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit tregtar;

dh) përshkrimin e kandidatit të propozuar për kontrollin e interesave (person fizik/juridik), përfshirë profilin e veprimtarisë;

e) informacion të detajuar mbi kontributin financiar të kandidatit në aktivitetin e licencuar;

ë) deklaratë nëse kuotat/aksionet, objekt transferimi, nuk janë të ngarkuara si garanci për detyrime ndaj të tretëve;

f) përshkrimin e detajuar të transaksionit të planifikuar dhe strukturën e pronësisë dhe të të drejtave të votës;

g) shtetet ku personi përvetësues dhe ndërmarrja objekt kryejnë veprimtari ekonomike përkatëse;

gj) financimin e investimit të huaj direkt dhe burimin e këtij financimi;
h) datën e planifikuar ose faktike të përfundimit të investimit;
i) strukturën aksionare (përfshirë ndryshimet);
j) strukturën e bordit drejtues (përfshirë ndryshimet);
k) njoftimin nëse transaksioni i nënshtrohet edhe kontrollit të përqendrimeve sipas legjislacionit të BE-së ose kombëtar;

l) njoftimin nëse investimi ka ose mund të ketë ndikim në projekte ose programe me interes të Bashkimit Evropian;

ll) deklaratën e konfliktit të interesit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në organizata të tjera ose shoqëri private/shtetërore.

2. Bashkëlidhur kërkesës, përveç informacionit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, pranë sekretariatit duhet të depozitohet, gjithashtu:

a) dokumentacioni për regjistrimin e ndërmarrjes objekt, sipas legjislacionit tregtar;
b) dokumentacioni për regjistrimin e aksionarëve ekzistues në ndërmarrjen objekt (nëse persona juridik), sipas legjislacionit tregtar të vendit të regjistrimit;

c) dokumentacioni për regjistrimin e personit përvetësues (kur person juridik), sipas legjislacionit tregtar të vendit të regjistrimit;

ç) vendimet e organeve drejtuese të ndërmarrjes objekt për miratimin e transferimit;

d) vendimet e organeve drejtuese të ortakëve/aksionarëve (kur janë persona juridikë) për miratimin e transferimit;

dh) vendimi i pranimit nga shoqëria ose personi që merr kuotat/aksionet, me angazhimin për vijimin e veprimtarisë;

e) dokumentacioni për identifikimin e pronarit përfitues dhe të personit kontrollues përfundimtar, sipas legjislacionit për regjistrin e pronarëve përfitues;

ë) dokumentacioni ligjor për gjendjen gjyqësore të ndërmarrjes objekt;

f) dokumentacioni ligjor për gjendjen gjyqësore të investitorit të huaj;

g) kontrata paraprake e shitjes së kuotave/aksioneve, kontratë dhurimi ose çdo dokument tjetër që vërteton kalimin e pronësisë tek pala blerëse, kopje e njësuar me origjinalin;

gj) lejet/licencat/autorizimet e disponueshme nga ndërmarrja objekt apo ato në proces aplikimi;

h) miratimin/njoftimin e autoritetit shtetëror kompetent për transferimin e kërkuar, nëse kjo kërkohet nga legjislacioni sektorial;

i) vendimin gjyqësor të formës së prerë (nëse ka) ku është vendosur ndryshimi i ortakut/aksionarit të ndërmarrjes objekt;

j) origjinën e burimeve financiare për kryerjen e transaksionit, që të vërtetuara përkohë me periudhën e kryerjes së transaksionit tregtar për kalimin e kuotave;

k) CV të ndërmarrjes objekt;

l) CV të investitorit të huaj nëse është person juridik.

3. Sekretariati mund të kërkojë dokumente ose informacione shtesë, kur kjo është e nevojshme për vlerësimin e rrezikut për sigurinë ose rendin publik, në përputhje me parashikimet e legjislacionit sektorial.

4. Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose kopje e njësuar me dokumentin origjinal, ose me nënshkrim/vulë elektronike në rastin kur këto aplikohen sipas legjislacionit në fuqi.

5. Dokumentacioni i lëshuar nga autoritetet e huaja duhet të jetë i apostilluar/legalizuar dhe i përkthyer në shqip në formë noteriale. Vërtetimet dhe deklaratat duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 (një) muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

6. Mosparaqitja e dokumentacionit të plotë ose paraqitja e informacionit të pasaktë përbën shkak për pezullimin ose mospranimin e shqyrtimit të kërkesës, sipas procedurave të parashikuara në këtë rregullore.

7. Formulari i kërkesës për autorizim, si dhe dokumentacioni i detajuar, që duhet të paraqitet sipas sektorëve përkatës, miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

8. Shqyrtimi i aplikimit nga sekretariati do të bëhet pa pagesë.

9. Të dhënat dhe dokumentet e procedurës së lejes së investimeve të huaja përfshihen në sistemin e informacionit të strukturës pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë.

10. Të dhënat dhe dokumentet e procedurës së shqyrtimit të investimeve të huaja ruhen në sistemin e informacionit të mbikëqyrjes së strukturës pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë për 7 (shtatë) vjet nga përfundimi i procedurës.

KAPITULLI IV PROCEDURA E SHQYRTIMIT DHE VENDIMARRJA

Neni 17

Procedurat e shqyrtimit

1. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga propozimi i sekretariatit, KNIHD-ja merr vendim të arsyetuar për:

- a) mosfillimin e hetimit të detajuar;
- b) fillimin e procedurës së hetimit të detajuar.

2. Afati i përcaktuar më lart mund të zgjatet vetëm një herë për jo më shumë se deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike në rast se:

a) nevojitet informacion/dokumentacion shtesë nga investitori i huaj, ndërmarrja objekt, Komisioni, vendet anëtare të Bashkimit Evropian apo institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ky informacion/dokumentacion pritët të konkludohet brenda këtij afati;

b) për raste komplekse në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

3. Në përfundim të hetimit të detajuar, KNIHD-ja mund të vendosë:

- a) miratimin e autorizimit;
- b) miratimin e autorizimit me kushte për eliminimin ose zbutjen e rrezikut;
- c) refuzimin e autorizimit, kur rreziku për sigurinë kombëtare ose rendin publik nuk mund të eliminohet me masa proporcionale;

ç) pezullimin e autorizimit deri në plotësimin e dokumentacionit/informacionit.

4. Marrja e autorizimit nga KNIHD-ja përbën një parakusht për t'u pajisur me leje, licenca, autorizime publike për nënshkrimin e kontratave publike ose për pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik, ose ankande publike, sipas legjislacionit sektorial të zbatueshëm.

5. Kundër vendimeve të KNIHD-së lejohet ankimi i drejtpërdrejtë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë të Tiranës, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit.

6. Nëse fillohet një hetim i detajuar, sekretariati njofton Komisionin Evropian dhe shtetet anëtare për investimin e huaj, në përputhje me përcaktimet dhe afatet e parashikuara nga rregullorja (BE) 2019/452.

7. Kur KNIHD-ja, nëpërmjet sekretariatit, vlerëson se një investim i huaj direkt që po i nënshtrohet shqyrtimit në një shtet anëtar të BE-së ka të ngjarë të ndikojë në sigurinë e vendit ose

rendin publik, ose ka informacione relevante për një shqyrtim të tillë, ai mund t'i japë komente shtetit anëtar të BE-së që kryen shqyrtimin. Komiteti i dërgon këto komente Komisionit Evropian njëkohësisht.

8. KNIHD-ja, nëpërmjet sekretariatit, i cili vlerëson siç duhet se një investim i huaj direkt në territorin shqiptar ka të ngjarë të ndikojë në sigurinë kombëtare ose rendin publik, mund t'i kërkojë Komisionit Evropian të japë vërejtje ose shteteve anëtare të BE-së të japin komente.

9. KNIHD-ja mund t'i kërkojë sekretariatit të kërkojë nga investitori informacione ose dokumente shtesë, si dhe ta njoftojë investitorin për zhvillimin e një seance dëgjimore, e cila ka karakter vullnetar dhe nuk cenon apo paragjykon procesin e vendimmarrjes.

10. KNIHD-ja, gjithashtu, mund t'i kërkojë investitorit të kërkojë informacione ose dokumente nga çdo person ose ndërmarrje tjetër, përveç informacionit të mbrojtur nga privilegji avokat-klient ose sekreti ekuivalent profesional ligjor.

11. Të gjitha dokumentet e tjera të kërkuara, duke përfshirë informacionin e ndjeshëm tregtar ose konfidencial, duhet të dorëzohen. Mosparaqitja e dokumenteve të kërkuara brenda afateve të specifikuara do të jetë një arsye e vlefshme për zgjatjen e afateve të procedurës.

12. Nëse sekretariati merr njoftim për komentet nga Komisioni Evropian ose shtetet anëtare të BE-së, afatet procedurale të përcaktuara në pikën 1 pezullohen derisa këto komente të jenë pranuar dhe shqyrtuar siç duhet.

13. Pranimi i mendimit të ekspertit, i cili duhet të mbahet konfidencial, pezullon afatin e pikës 1 për 20 (njëzet) ditë kalendarike. Ekspertët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin.

14. Nëse ndërmarrja objekt ka nisur ose pritët të nisë procedurat e likuidimit/falimentimit, afatet përgjysmohen.

Neni 18

Investimet e huaja direkte që ka të ngjarë të ndikojnë në projekte ose programe me interes të Bashkimit

1. Kur një investim i huaj direkt në Shqipëri konsiderohet se ka të ngjarë të ndikojë në projekte ose programe të Bashkimit Evropian për arsye sigurie, ose rendi publik, sekretariati njofton Komisionin Evropian dhe merr në konsideratë vërejtjet e tij.

2. Në varësi të vërejtjeve, sekretariati ka të drejtë të iniciojë procedurën e shqyrtimit *ex officio*.

3. Procedurat e parashikuara në nenet përkatëse të kësaj rregulloreje zbatohen *mutatis mutandis*, duke marrë parasysh sa vijon:

a) Shqipëria, gjatë njoftimit ose shkëmbimit të informacionit, mund të tregojë nëse investimi i huaj direkt ka të ngjarë të ndikojë në projektet ose programet e BE-së;

b) Struktura përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për ekonominë duhet t'i marrë në konsideratë maksimalisht vërejtjet e Komisionit Evropian dhe, në rast mosrespektimi të këtyre vërejtjeve, duhet të japë një justifikim me shkrim.

4. Për qëllimet e këtij neni, "projekte ose programe me interes të Bashkimit" nënkupton projektet ose programet e listuara në shtojcën e rregullores (BE) 2019/452, përfshirë çdo ndryshim, ose përditësim të saj, si dhe projektet ose programet që:

a) përfitojnë të paktën 5 (pesë) milionë euro financim nga Bashkimi Evropian;

b) ose përbëjnë 25% ose më shumë të financimit total të Bashkimit Evropian për programin përkatës;

c) ose lidhen me infrastrukturën kritike, teknologjitë kritike ose inputet kritike thelbësore për sigurinë ose rendin publik, sipas përcaktimeve të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Evropian.²

Neni 19

Ofrimi i informacionit në shqyrtimin e investimeve të huaja direkte

1. Sekretariati siguron që informacioni i njoftuar ose i kërkuar nga Komisioni Evropian dhe shtetet anëtare t'u vihet në dispozicion, pa vonesa të panevojshme dhe brenda afateve të arsyeshme për bashkëpunim ndërinstitucional.

2. Informacioni duhet të përfshijë:

a) strukturën e pronësisë së investitorit të huaj dhe të ndërmarrjes në të cilën është planifikuar ose është kryer investimi i huaj direkt, duke përfshirë informacionin mbi investitorin përfundimtar dhe pjesëmarrjen në kapital;

b) vlerën e përafërt të investimit të huaj direkt;

c) produktet, shërbimet dhe operacionet e biznesit të investitorit të huaj dhe të ndërmarrjes në fjalë;

ç) shtetet anëtare të BE-së në të cilat investitori i huaj dhe ndërmarrja kryejnë operacione përkatëse biznesi;

d) financimin e investimit dhe burimin e tij, bazuar në informacionin më të mirë të disponueshëm;

dh) datën në të cilën investimi i huaj direkt është planifikuar të përfundojë ose është përfunduar.

3. Sekretariati, kur është e mundur, duhet t'i ofrojë Komisionit Evropian dhe shteteve anëtare të BE-së kërkuese çdo informacion shtesë, përveç atij të përmendur në pikën 2, brenda afateve të kërkuara dhe, në mungesë të tyre, brenda një afati të arsyeshëm për marrjen e këtij informacioni.

4. Sekretariati mund t'i kërkojë investitorit të huaj ose ndërmarrjes objekt dhënien e informacionit shtesë, i cili paraqitet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës.

5. Në rrethana të jashtëzakonshme, kur, pavarësisht përpjekjeve të saj më të mira, sekretariati nuk është në gjendje të marrë informacionin e kërkuar, ajo njofton pa vonesë Komisionin Evropian dhe shtetet anëtare të BE-së përkatëse. Njoftimi duhet të justifikojë siç duhet arsyet për mosdhënien e informacionit dhe të shpjegojë përpjekjet e ndërmarra, duke përfshirë çdo kërkesë të bërë në përputhje me sa më lart.

Neni 20

Shqyrtimi *ex officio*

1. Kur sekretariati konstaton me çdo mjet ligjor, përfshirë informacion nga burime të besuara vendase ose ndërkombëtare apo mekanizma të tjerë, sipas kësaj rregulloreje se është kryer ose po kryhet një investim i huaj direkt që i nënshtrohet detyrimit për njoftim, ose autorizim sipas këtij akti dhe për të cilin nuk është paraqitur njoftim ose kërkesë për autorizim, ai njofton investitorin e huaj dhe ndërmarrjen objekt, dhe i kërkon paraqitjen e kërkesës, dhe dokumentacionit përkatës, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga momenti i kërkesës. Në këtë rast, përgjegjësia për mosplotësimin e dokumentacionit është solidare.

2. Në rast se investitori i huaj ose ndërmarrja objekt nuk paraqesin kërkesën ose dokumentacionin e kërkuar, autoriteti përgjegjës fillon procedurën *ex officio* për shqyrtimin e

² [Rregullorja - 2019/452 - EN - EUR-Lex](#)

investimit dhe njofton pa vonesë palët për fillimin e saj, duke u kërkuar plotësimin e informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm. Në këtë fazë, procedura *ex officio* zhvillohet sipas të njëjtave rregulla procedurale, afate dhe garanci si procedura e shqyrtimit e iniciuar mbi bazë kërkesë, referuar në nenet 15, 16, 17, të kësaj rregulloreje, duke filluar nga data e njoftimit për fillimin e procedurës *ex officio*.

3. Kur investimi është realizuar tërësisht ose pjesërisht dhe nga shqyrtimi *ex officio* rezulton se ekziston rrezik real për sigurinë ose rendin publik, Komiteti Ndërminstoror për Shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte (KHIHD) mund të vendosë:

- a) kushte korigjuese pasuese, me qëllim eliminimin e këtij rreziku;
- b) nëse kushtet nuk janë të mjaftueshme për eliminimin e rrezikut, mund të urdhërojë zgjidhjen e pasojave të investimit (*unwinding*), tërësisht ose pjesërisht.

KAPITULLI V STRUKTURAT E RAPORTIMIT DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

Neni 21

Pika e kontaktit

1. Pika e kontaktit do të shërbejë si ndërlidhësi kryesor për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e këtij vendimi, duke përfshirë komunikimet me investitorët, autoritetet kombëtare, Komisionin Evropian dhe shtetet anëtare.

2. Do të sigurohet një sistem i sigurt dhe i koduar për të mbështetur bashkëpunimin dhe shkëmbimin e drejtpërdrejtë të informacionit midis pikave të kontaktit.

Neni 22

Përpunimi i të dhënave personale

1. Përpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave personale, në kuadër të këtij vendimi, kryhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij dhe vetëm për aq sa është e nevojshme për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte, dhe për të siguruar efektivitetin e mekanizmit të bashkëpunimit të parashikuar në këtë rregullore.

2. Të dhënat personale, që lidhen me zbatimin e kësaj rregulloreje, do të ruhen vetëm për periudhën e nevojshme për të arritur qëllimet për të cilat janë mbledhur, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

KAPITULLI VI PASOJAT LIGJORE

Neni 23

Pasojat e ndalimit, anulimit ose vendosjes së kushteve ose masave lehtësuese

1. Kur një investim i huaj direkt ndalohet, anulohet ose autorizohet me kushte ose masa zbutëse, me vendim të KNIHD-së, në përputhje me këtë rregullore, marrëveshjet përkatëse të investimit

janë të pavlefshme ose prodhojnë efekte juridike vetëm në përputhje me kushtet ose masat e vendosura.

2. Vendimi i KNHID-së, që përcakton pavlefshmërinë absolute/të pjesshme, përmban:

a) anulimin e marrëveshjes së blerjes së aksioneve ose të marrëveshjeve të tjera të lidhura me investimin;

b) përcaktimin e një afati kohor për përmbushjen e kushteve ose masave zbutëse;

c) përcaktimin e masave të nevojshme për korrigjimin ose eliminimin e pasojave të investimit të ndaluar ose të pavlefshëm.

3. Në disa raste, KNIHD-ja mund të mos pengojë pjesëmarrjen e investitorit të huaj në ndërmarrje, nëse kjo pjesëmarrje nuk i tejkalon kufijtë e përcaktuar në nenin 14 të kësaj rregulloreje.

KAPITULLI VII DISPOZITA KALIMTARE

Neni 24

Dispozita kalimtare

1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe zbatohet për investimet e huaja direkte, sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, që lidhen ose prekin:

a) sektorin e medias, si sektor i ndjeshëm;

b) industrinë e mbrojtjes, si sektor veçanërisht i ndjeshëm, sipas përcaktimeve të shtojcave përkatëse.

2. Me përjashtim të dispozitave që rregullojnë bashkëpunimin me Bashkimin Evropian dhe të investimeve që lidhen me projekte ose programe me interes të Bashkimit Evropian, të cilat zbatohen plotësisht nga momenti i anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ky vendim zbatohet në përputhje me pikën 1, të këtij neni.

3. Rregullat për detajimin e përbërjes, organizimit, funksionimit dhe mekanizmave të shqyrtimit, të parashikuar në këtë vendim sipas neneve 5–11, dhe formati i kërkesës për autorizim sipas nenit 16, pika 9, hyjnë në fuqi pas përfundimit të periudhës tranzitore prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të tij, periudhë brenda së cilës miratohet udhëzimi i detajuar për zbatimin e këtij vendimi.

4. Pika e kontaktit do të caktohet sipas urdhrat të ministrit përgjegjës për ekonominë brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të tij të këtij vendimi.

5. Gjatë periudhës tranzitore, investitorët e huaj inkurajohen, në mënyrë vullnetare, të njoftojnë pranë autoritetit kompetent investimet që mund të bien në fushën e zbatimit të këtij vendimi.

6. Investimet e huaja direkte të realizuara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi nuk i nënshtrohen shqyrtimit sipas këtij akti. Këto investime mund t'i nënshtrohen shqyrtimit vetëm në rastet kur, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi:

a) paraqesin rrezik real dhe të identifikueshëm për sigurinë ose rendin publik; dhe/ose

b) pësojnë ndryshime materiale thelbësore, përfshirë, por pa u kufizuar në ndryshime në strukturën e pronësisë, kontrollit, përdorimit, financimit ose qëllimit ekonomik të investimit; dhe/ose

c) ka indicie të bazuara për ndikimin e një vendi të tretë në investim.

7. Përfshirja e sektorëve sipas këtij vendimi bëhet ekskluzivisht për qëllime të shqyrtimit të investimeve të huaja direkte dhe nuk cenon, nuk zëvendëson dhe nuk modifikon klasifikimet ose

regjimet e kontrollit, të parashikuara në legjislacionin sektorial përkatës, as kompetencat e institucioneve përgjegjëse në këtë drejtim.

SHTOJCA 1
SEKTORË TË NDJESHËM
(listë orientuese)

Në këtë kategori përfshihen, veçanërisht:

Në kuptim të këtij vendimi, sektorë të ndjeshëm konsiderohen sektorët dhe veprimtaritë ekonomike ku investimet e huaja direkte mund të paraqesin rrezik për sigurinë ose rendin publik, përfshirë menaxhimin e krizave dhe shërbimet me interes të përgjithshëm, veçanërisht kur lidhen me infrastrukturë kritike, teknologji kritike, burime thelbësore ose akses në informacion të ndjeshëm të cilat ndikohen ose riskojnë të ndikohen nga një vend i tretë.

Në këtë kategori përfshihen, në veçanti;

1. Infrastruktura kritike

Institucione, sisteme, objekte, procese, rrjete ose pjesë të tyre, që janë thelbësore për funksionimin e shtetit, ekonomisë dhe shoqërisë, përfshirë veçanërisht:

- a) energjinë;
- b) teknologjinë e informacionit;
- c) transportin;
- ç) shëndetësinë;
- d) ushqimin;
- dh) telekomunikacionin;
- e) përpunimin ose ruajtjen e të dhënave;
- ë) mbrojtjen;
- f) bankat dhe institucionet financiare;
- g) institucionet kërkimore;
- gj) sistemet sociale dhe të shpërndarjes;
- h) industrinë kimike;
- i) investimet në tokë dhe ndërtesa që janë thelbësore për përdorimin dhe funksionimin e infrastrukturave të përmendura më sipër.

2. Teknologjitë kritike dhe mallrat me përdorim të dyfishtë

Teknologjitë dhe mallrat që, për shkak të natyrës ose përdorimit të tyre, mund të ndikojnë në sigurinë ose rendin publik, përfshirë veçanërisht:

- a) inteligjencën artificiale;
- b) robotikën;
- c) gjysmëpërçuesit;
- ç) sigurinë kibernetike;
- d) teknologjitë e mbrojtjes;
- dh) teknologjitë kuantike dhe bërthamore;
- e) nanoteknologjitë;
- ë) bioteknologjitë.

3. Siguria e furnizimit me burime kritike

Veprimtaritë që lidhen me sigurimin dhe vazhdimësinë e furnizimit me burime thelbësore për funksionimin e shtetit dhe ekonomisë, përfshirë:

- a) furnizimin me energji;

- b) furnizimin me lëndë të para;
- c) furnizimin ushqimor;
- ç) furnizimin me barna dhe vaksina, pajisje mjekësore dhe pajisje mbrojtëse personale, përfshirë kërkimin dhe zhvillimin në këto fusha.

4. Aksesimi në informacion të ndjeshëm

- a) Veprimtaritë që përfshijnë aksesin, përpunimin, ruajtjen ose kontrollin e informacionit të ndjeshëm, përfshirë të dhënat personale, shtetërore, të klasifikuara, ose aftësinë për të ushtruar kontroll mbi këtë informacion;
- b) Krijimi, zhvillimi, administrimi i sistemeve TIK/SHI, përfshirë sistemet *e-albania*, *e-rezidenca*, *tech space*, *smart e-albania* etj.;
- c) Shërbimet e besuara sipas legjislacionit në fuqi.

5. Media

Veprimtaritë që lidhen me median dhe shpërndarjen e informacionit, kur investimi i huaj mund të ndikojë në lirinë, pavarësinë ose pluralizmin e medias dhe në formimin e opinionit publik.

SHTOJCA 2 **SEKTORË VEÇANËRISHT TË NDJESHËM** (listë shteruese)

Në kuptim të këtij vendimi, sektorë veçanërisht të ndjeshëm konsiderohen sektorët dhe veprimtaritë ekonomike ku investimet e huaja direkte mund të krijojnë rrezik të drejtpërdrejtë, serioz dhe të menjëhershëm për sigurinë kombëtare, rendin publik, shëndetin publik, funksionimin e infrastrukturës kritike ose sovranitetin shtetëror, veçanërisht kur lidhen me operimin e sistemeve, rrjeteve ose aseteve thelbësore.

Në këtë kategori përfshihen ekskluzivisht:

1. Industria e mbrojtjes, përfshirë veprimtaritë që lidhen me mallra, artikuj, teknologji, *software* dhe shërbime ushtarake, teknologji me përdorim të dyfishtë, si dhe raste të zbatimit të parimit *catch-all*, edhe kur nuk janë të përfshira në lista të posaçme kontrolli.³

2. Infrastruktura kritike energjetike, përfshirë prodhimin, tregtimin, furnizimin, operimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

3. Operimi i infrastrukturës kritike digjitale, përfshirë rrjetet publike të komunikimeve elektronike, infrastrukturën 5G dhe teknologjitë pasuese, qendrat e të dhënave, shërbimet *cloud*, sistemet DNS dhe TLD, sistemet qeveritare *e-albania*, *e-rezidenca*, *tech space*, *smart e-albania*, si dhe çdo infrastrukturë tjetër digjitale që është thelbësore për funksionimin e shtetit, ekonomisë dhe të dhënave personale, sensitive, shtetërore, të klasifikuara.

4. Furnizimi me ujë dhe menaxhimi i burimeve ujore, përfshirë furnizimin me ujë të pijshëm dhe sistemet e trajtimit të ujërave të ndotura, kur këto përbëjnë infrastrukturë kritike për shëndetin publik dhe sigurinë kombëtare.

5. Operimi i sistemeve që garantojnë sovranitetin e të dhënave të Republikës së Shqipërisë, përfshirë sistemet, infrastrukturën dhe shërbimet që sigurojnë ruajtjen, përpunimin, kontrollin, aksesin dhe mbrojtjen e të dhënave strategjike shtetërore ose publike, si dhe të dhënave sensitive me rëndësi kombëtare.

³ Për qëllime të këtij vendimi, teknologjitë dhe produktet me përdorim të dyfishtë do të identifikohen në përputhje me listën e përbashkët të artikujve me përdorim të dyfishtë, sipas Rregullores (BE) 2021/821, ndërsa pajisjet dhe teknologjitë ushtarake identifikohen sipas Listës Ushtarake të Bashkimit Evropian, miratuar me Qëndrimin e Përbashkët 2008/944/CFSP dhe legjislacionin kombëtar.

6. Teknologjitë financiare dhe të sigurimeve, përfshirë:

- a) *FinTech*, kur lidhet me sisteme pagesash, kreditimi ose stabilitet financiar;
- b) *InsurTech*, kur lidhet me menaxhimin e rrezikut sistemik.

7. Kontratat inteligjente (*Smart Contracts*), kur përdoren në sektorë financiarë, energjetikë, shërbime publike ose infrastruktura kritike dhe ndikojnë në kontrollin, funksionimin ose sigurinë e sistemeve thelbësore.

8. Investimet strategjike, sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike, përfshirë projektet dhe marrëveshjet e partneritetit me Korporatën e Investimeve Shqiptare ose entitete të tjera shtetërore të krijuara për realizimin e tyre.

9. Shoqëritë, projektet ose asetet e krijuara, zhvilluara ose administruara në kuadër të investimeve strategjike ose partneriteteve shtetërore.

10. *Joint Ventures*.